

KËRKESË
Nr.502, datë 26.1.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Himarë e Vjetër-Potam (shitesa)”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Vërtetim” nga dokumenti hipotekor do të kërkohet dhe një herë rikonfirmimi përfundimtar nga zyra e regjistrimit Vlorë.

Vlera e këtij shpronësimi për sipërfaqen totale të tokës truall prej 33m² me vlerë shpronësimi prej 105 600 (njëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekësh, si dhe me një vlerë shpronësimi për objekt prej 562 387 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 667 987 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

**LISTA (SHITESË) EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “HIMARË E VJETËR-POTAM”**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. vërt. hip.	Lloji i pasurisë						Shënime	
						Truall			Objekte				
						Sip. M ²	Çmimi Lek/m ²	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë	Vlera totale lekë	Vërt. Kon. ZVRRPP	Hip
1	Fotaq	Llambro	Bollano	1952	232	33	3200	105600	Banesë	562387	667987		
	Totali							105600		562387	667987		

Shënim. Vlerësimi i objektit të pasqyruar në këtë listë është bërë në bazë të çmimeve të zërave të punës të konfirmuara nga EKB-ja.